



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Data: 9 Mars 2023

Nr: 150

Ora: 12:00

V E N D I M

P Ë R

**SHQYRTIMIN ADMINISTRATIV NDAJ PERSONIT PËRGJEGJËS TË BASHKISË POGRADEC, PËR  
RAPORTIMIN E VEPRIMTARIVE PUBLIKE, PËR ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES  
VENDORE TË DATËS 14 MAJ 2023**

Sot më datë 9 Mars 2023, unë Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve mora në shqyrtim çështjen administrative me:

**SUBJEKT:** Z. Artin Halili, person përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike në bashkinë Pogradec

**OBJEKT:** Shqyrtim administrativ ndaj personit përgjegjës të bashkisë Pogradec, për raportimin e veprimtarive publike

**BAZA LIGJORE:** Në mbështetje të nenit 19, pika 1, shkronjat “dh”, “f” dhe “n”, pika 2, neneve 91, 92 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, vendimit nr. 9, datë 9.3.2021 dhe vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator

Në përfundim të këtij shqyrtimi,

**K O N S T A T O J :**

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, më datë 27.2.2023, në adresën e postës elektronike, të Koordinatorit për të Drejtën e Informimit, ka marrë indicie për organizimin e 1 (një) veprimtarie publike nga ana e bashkisë Pogradec.

Indicia është marrë nëpërmjet provave ku pretendohet si në vijim:

“Në kuadër të 15-vjetorit të Pavarësisë së Kosovës, në ambientet e Qendrës Rinore u mbajt një takim me të rinjtë e shkollave të mesme”.

Data: 9 Mars 2023

Nr: 150  
Ora: 12:00



“Për shqyrtimin administrativ ndaj personit përgjegjës të bashkisë Pogradec, për raportimin e veprimtarive publike”

Link:

<https://www.facebook.com/photo/?fbid=574138071415398&set=pcb.574138181415387>

Mbështetur në përcaktimet e nenit 8, pika 3, të vendimit nr. 9, datë 9.3.2021, të Komisionit Rregullator, pasi shqyrtova paraprakisht çështjen, vlerësoj se informacioni apo të dhënat e treguara krijojnë një bazë të mjaftueshme për të nisur hetimin administrativ.

Neni 19, pika 1, shkronjat “dh”, “f” dhe “n” e pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar përcakton kompetencat që ushtron Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve.

Më datë 27.2.2023, bashkisë Pogradec i është kërkuar informacion në lidhje me indicien e marrë, nëpërmjet adresës elektronike.

Më datë 27.2.2023, ora 4:06 PM, bashkia Pogradec bën me dije se: *“Unë Artin Halili si pika e kontaktit për raportim nuk isha pajisur ende me kredencialet për t’u loguar në sistemin e KQZ-së në mënyrë që të bëja raportimin.”*

*Aktiviteti është organizuar në datë 17 Shkurt, ora 13:00. Organizator ishte Drejtoria e Turizmit, Trashëgimisë kulturore dhe Rinisë. Folës në aktivitet ishin zj. Entela Gusho zv/kryetare dhe z. Ledian Zeqollari Drejtor i Turizmit. Aktiviteti u realizua në ambientet e Qendrës Rinore dhe merrnin pjesë të rinj nga Këshilli Rinor Vendor dhe të rinj nga dy gjimnazet e qytetit. Në takim u fol për Kosovën dhe rrugëtimin e saj deri në arritjen e mëvetësisë nga Serbia. Takimi ishte i hapur edhe për median dhe është pasqyruar në median lokale Tv Sot7.”*

Pas verifikimit të rrethanave dhe fakteve, vlerësohet se mungesa e informacionit si dhe problematikat me sistemin dhe pajisjen me kredencialet kanë ardhur për shkak të vështirësive në aksesimin e ndërfaqes së raportimeve dhe për shkaqe të tjera objektive jashtë vullnetit të organit publik.

Në këto kushte, duke qenë se qëllimi nuk ka qenë shmangia nga përgjegjësia ligjore e raportimit, vlerësoj se duhet mirëkuptuar situata e krijuar dhe të pushohet hetimi administrativ për ato shkelje që lidhen me çështjen objekt shqyrtim.

#### **PËR KËTO ARSYE:**

Bazuar në nenin 19, pika 1, shkronjat “dh”, “f” dhe “n”, pika 2, nenet 91, 92 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, vendimit nr. 9, datë 9.3.2021, dhe vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator në Komisionit Qendror të Zgjedhjeve

#### **V E N D O S:**

Data: 9 Mars 2023

Nr: 150

Ora: 12:00



“Për shqyrtimin administrativ ndaj personit përgjegjës të bashkisë Pogradec, për raportimin e veprimtarive publike”

1. Pushimin e procedimit administrativ ndaj z. Artin Halili, person përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike, në bashkinë Pogradec.
2. Tërheqje vëmendje ndaj bashkisë Pogardec, për marrjen e masave të menjëhershme, për raportimin e veprimtarive publike.
3. Rezultatet e këtij vendimi i njoftohen palës nëpërmjet postës elektronike.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

**Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**

**Ilirjan CELIBASHI**

Data: 9 Mars 2023

Nr: 150  
Ora: 12:00



“Për shqyrtimin administrativ ndaj personit përgjegjës të bashkisë Pogradec, për raportimin e veprimtarive publike”